VENDIM
Nr. 269, datë 28.12.2020

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E "METODOLOGJISË SË LLOGARITJES SË TARIFËS PËR SHËRBIMIN E RIGAZIFIKIMIT NGA IMPIANTET E GNL" NË SHQIPËRI

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, nenit 16, pika 1, germa "a", të ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 26, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 142/12 prot., datë 24.12.2020, të përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror, mbi fillimin e procedurës për miratimin e "Metodologjisë për llogaritjen e tarifës për shërbimin e rigazifikimit nga impiantet e GNL-s" në Shqipëri,

konstatoi se:

- Metodologjia për llogaritjen e tarifës për shërbimin e rigazifikimit nga impiantet e GNL-së" është hartuar si dokument në përputhje me ligjin nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar, dhe do të zbatohet për subjektet e Sistemit të GNL-së, të cilët janë persona juridikë, të licencuar nga ERE dhe që:
- i përkasin sistemit kombëtar të gazit siç përcaktohet në nenin 4, pika 17, të ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar, dhe operojnë, mirëmbajnë e zhvillojnë një impiant GNL;
- kanë marrë miratimin për përdorimin e impianteve ekzistuese të sistemit, në përputhje me nenin 11 dhe nenin 69, të ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar;
- u nënshtrohen rregullave të përgjithshme për aksesin dhe sigurimin e shërbimit të rigazifikimit nga impiantet e GNL-së, sipas dispozitave të ligjit nr. 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror", i ndryshuar (nenet 68–74);
- impianti i GNL-së është i lidhur me sistemin e transmetimit;
- shkarkon dhe rigazifikon GNL-në, sipas kontratave të nënshkruara;
- Operatori i shërbimit të GNL-së do të zbatojë rregullat e kësaj metodologjie për qëllimin e përcaktimit të tarifave nga ERE. Përcaktimi i tarifave sipas kësaj metodologjie do të bazohet në metodën RoR;
- Operatorit të rrjetit do t'i lejohet të mbulojë kostot e justifikuara për rrjetin, si dhe një kthim mbi investimin. ERE do të miratojë tarifat e rrjetit kur të plotësohen kushtet dhe parimet e kësaj metodologjie;
- tarifat e përdorimit të rrjetit të aprovuara nga ERE do të jenë të vlefshme për një periudhë ushtrimore (1-vjeçare) për periudhën e parë rregullatore, si dhe do të jenë në përputhje me periudhën rregullatore të zbatuar për operatorët e rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes;
- shmangia nga çdo parashikim i kësaj metodologjie do të çojë në refuzimin nga ERE të aplikimit për tarifë të operatorit të GNL-së;
- tarifat e rrjetit do të llogariten dhe miratohen nga ERE në bazë të kostove të arsyeshme që operatori i GNL-së përdor për realizimin e aktivitetit dhe që janë në përputhje me këtë metodologji;
- gjithashtu, dispozitat e "Metodologjisë për llogaritjen e tarifës për shërbimin e rigazifikimit nga impiantet e GNL-së" do zbatohen për qëllimet e përcaktimit të të ardhurave referuese dhe tarifave për shërbimin e rigazifikimit të GNL-së të siguruar nga depozitat e GNL-së, të konsideruara strategjike të impianteve funksionale për procesin e rigazifikimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e "Metodologjisë për llogaritjen e tarifës për shërbimin e rigazifikimit nga impiantet e GNL-s" në Shqipëri.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti